



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**i mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 7.5.2024, duke filluar në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna,, Leutrim Retkoceri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi dhe Mirsad Vitia.

**Mungoi:** Bahri Gashi dhe Shegë Beqiri.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Shkëmb Manaj - këshilltar për çështje ligjore, Osman Bllaca, Valbona Ahmeti-Makolli - drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë.

Mbledhjen e hapin dhe e kryesoi, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

### REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raport vjetor i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023;
3. Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM 4);
4. Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023;
5. Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1);
6. Propozim-vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023;
7. Propozim-vendimi për vënien në konsultim publik për Projekt rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
8. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Kryesuesi propozoi që të hyjë si pikë e rendit të ditës kërkesa e Sindikatës së punëtorëve të administratës të Komunës së Prishtinës Propozim - vendimi për financimin e shujtave ditore për shërbyesit civilë për vitin 2023 dhe 2024, pasi për vitin 2022 i kanë marrë. **Nora Kelmendi:** pyeti pse i kanë ndal shujtat për vitin 2023.

**Valbona Makolli:** nuk ka marrëveshje.

**Milazim Vitija:** vetëm në kuvend e kemi miratuar.

**Gëzim Sveçla:** tha këta po e bëjnë gabimin pse nuk po i çesin në kod buxhetor, unë po mendoj se kjo vetëm me buxhet bëhet, për me nda shujta në këtë fazë gjithçka kthehet, mundemi me i votuar e me i mashtruar në kuvend që ka kaluar, por kjo do të kthehet.

**Valbona Makolli:** tha duhet me u konsultuar me zyrën ligjore.

**Shkëmb Manaj:** dha sqarime se pakoja e fundvitit që është ndarë me herët, auditori i përgjithshëm e ka gjet si shkelje edhe e kemi pasur të obliguar për me e ndal, e shujtat i kemi kaluar njëherë në kuvend, por MAPL e ka kthyer të kundërligjshme, por tani punëtorët po e realizojnë atë të drejtë por me përmbarues, kështu e kanë realizuar për vitin 2022.

**Gëzim Sveçla:** cila ka qenë baza ligjore, vendimi i kuvendit komunal, kjo paska ardhur me datën 3 për këtë duhet me na jap kohë për me u konsultura, me na lënë në mbledhjen e fundit të muajit maj të konsultohemi të gjithë, për rrugën më të mirë se si me gjete.

**Kryesuesi:** në rregull është.

### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë e Financa.**

**Kryesuesi tha se u miratua ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë e Financa.**

### **Pika e dytë**

**Raport vjetor i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023**

**Kryesuesi:** tha lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ishte dashur të jetë kryetari këtu, por nuk është, a dëshiron dikush në vend të kryetarit me marrë fjalën.

**Shkëmb Manaj:** tha se kryetari do të vinte, por ka pasur një takim urgjent, nuk kishte mundësi të jetë prezent, kështu që raporti është dorëzuar me sa e di është komplet, paraprakisht, përmbajtja kështu që në Kuvend e prezanton Kryetari.

**Gëzim Sveçla:** ne e kemi pranuar një raport me 20 apo 30 foto edhe 10 rreshta të shkruar asgjë tjetër, d.m.th. nuk kemi një tekst të shkruar, kam pritur se do të ketë një raport të shkruar ku do të flas për të gjitha drejtoritë për rezultatet e arritura. Ne jemi 24 orë para mbledhjes dhe ne ende nuk e kemi marrë atë raport.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Kryeqytetit për vitin 2023** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

### **Pika e tretë**

**Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM 4)**

Lidhur me këtë raport në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli** ku ceku se e kanë përgatitur materialin ju kemi dorëzuar, por unë sot më tepër kisha pasur dëshirë me i dëgjuar këtu nëse keni vërejtur ndonjë gabim ose lëshim nga ana jonë që të përmirësojmë deri nesër. Përndryshe ky është një raport para 6 apo 7 muajve, por të dhënat janë nga Ministria e Financave, kurse këtu përfshihet edhe raporti vjetor, drejtorët përgjegjës do të jenë nesër për projektet e veta, me përjashtim disa nga ish-kolegët që nuk janë këtu.

**Kryesuesi:** hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**Mirsad Vitia:** po mendoj te TM4, përfshihet te raporti financiar buxhetore për vitin 2023, ndoshta është mirë edhe në kuvend kur të diskutohen të diskutohen të dyja bashkë dhe të votohen veç e veç, kështu që nëse

mundemi me fol për 2023 në pika të shkurta në rregull jemi drejtoreshë.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2023 (TM 4)** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

### **Pika e katërt**

#### **Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023**

Lidhur me këtë raport në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli** ku ceku sa i përket raportit vjetor për vitin 2023, siç e keni parë janë paraqitur performanca e të hyrave të komunës për komplet vitin, po ashtu edhe performancën e shpenzimeve, realizimin e investimeve kapitale në vlerë dhe përqindje për secilën drejtori veç e veç, i kam paraqitur pagesat sipas marrëveshjes për vitin 2023. Po ashtu kemi paraqitur edhe vlerën e pasurisë kapitale, mbi vlerën 1000 euro dhe nën 1000 euro, po ashtu kemi njoftuar edhe anëtarët e kuvendit për ekzekutimin e rasteve dhe vendimeve gjyqësore nga thesari dhe në fund kemi konstatuar komplet buxhetin sa ka qenë, sa ka mbetur dhe sa është bartur. Po ashtu kemi njoftuar edhe anëtarët e kuvendit për ekzekutimin e rasteve dhe vendimeve gjyqësore nga thesari dhe në fund kemi konstatuar komplet buxhetin sa ka qenë, sa ka mbetur dhe sa janë bartur të hyrat vetanake për vitin 2024.

**Mirsad Vitia:** i parashtrori pyetje drejtoreshës se te investimet kapitale realizimi i të hyrave shënon 43%, këtë vlerë për 43% a e kanë rrit edhe këto marrëveshjet me ndërmarrjet publike.

**Valbona Makolli:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Mirsad Vitia:** tha disa mjete janë marrë edhe prej kategorisë së investimeve kapitale.

**Valbona Makolli:** dha sqarime se ajo ka qenë një marrëveshje 3-vjeçare 2022, 2023 dhe 2024 që është 3,080,000.00, në vazhdimësi nuk ka marrëveshje të re.

**Gëzim Sveçla:** tha tani ato 1 milion e gjysmë, që janë marrë prej rrugës A, i kish marrë thesari. Tani ato 1 milion e gjysmë figurojnë si investim kapital i shpenzuar, por vetëm po pyesë a figurojnë?

**Valbona Makolli:** tha besoj se po.

**Gëzim Sveçla:** e tash nëse figurojnë 1 milion e gjysmë a po rritet automatikisht në mënyrë përqindja e investimeve kapitale që d.m.th përqindja e paraqitur nuk është reale.

**Valbona Makolli:** tha se nuk e di sa është reale ai është shpenzim.

**Gëzim Sveçla:** tha shpenzim po, nuk ka dyshim, por jo investim kapital që i bien investimet kapitale janë më të vogla sesa që janë paraqitur.

**Valbona Makolli:** tha se paditësi varësisht qysh e hedh padinë Ministria e Financave e merr.

**Gëzim Sveçla:** po ashtu pyeti se sa ishte vlera e investimeve kapitale, vlera jo përqindja.

**Valbona Makolli:** buxheti komplet, vlera e investimeve kapitale 86,000,501.00 me bartje.

**Nora Kelmendi:** pyeti tek raportimi i detyrimeve kontingjente e keni ndryshuar, pse ka ardhur deri te ky ndryshim po me intereson.

**Valbona Makolli:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se te tek ndryshimet kur e keni sjellë këtë të renë, në të parën në faqe 14 kanë qenë shpenzimet për periudhën 12 mujore, 3 projektet kryesore janë përmend të parat projektet me marrëveshje me të mëdha të paguara janë këto 3 projekte, janë përmend menaxhimi i mbeturinave, trafiku urban dhe shpenzimet e projektit të arkitektit të kryeqytetit, këtë të dytën shpenzimet e projektit të arkitektit të kryeqytetit e keni heq krejt, nuk përmendet askund.

**Valbona Makolli:** po ashtu për këtë pyetje të parashtruar dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri:** pyeti drejtoreshën a e keni përgatitur raportin.

**Valbona Makolli:** tha se raportin normal që nuk e përgatiti unë e bënë stafi im, unë e kontrolloj e diskutoj e

shikoj edhe me Ministrinë e Financave, nganjëherë e kërkoj për me krahasuar jo që nuk i besoj, por me dy parë sy me shikuar është pak më ndryshe. Tutje tha se Ligji për Menaxhimin e Financave neni 45, duhet me i përmbajtur saktë çka don, çka kërkohet nuk guxojmë edhe me i ik edhe nëse nuk ka saktë çka duhet p.sh.45.6 dhe 45.7 ne nuk kemi çka në atë pikë, por jemi të detyruar të shkruajmë sepse ashtu kërkohet nga Ministria e Financave, për të deklaruar ka apo nuk ka ajo pikë.

**Leutrim Retkoceri:** pyetjen ju bëra se ka lëshime që ky raport financiar është bërë prej ati që na keni prezantuar vitin e kaluar, nëse hyn te pasqyrat e shpenzimeve, investimeve kapitale, suficitit d.m.th ka pjesë që mungojnë p.sh. suficitin financiar nuk e keni te deklaruar hiç, tek tabelat por kjo nuk po besoj se është vërejtje se duhet të komentohet me ju është mirë me i thanë nënkryetarit të komunës që kur t'i bon është gabim me mshef shifra në deklarim të raportit financiar.

**Valbona Makolli:** jo duhet me shkruar se ligji e kërkon që Kuvendi me i deklaruar, jemi duke biseduar për buxhetin fillestar, këto shifrat të cilat i kemi deklaruar në faqen e parafundit..

**Leutrim Retkoceri:** tha shikoni të parën dhe të dytën, nëse i lexoni paragrafi i fundit, nuk e ke hiç d.m.th ka ndryshim nga këto ne që i diskutojmë në seancë sugjerimi im drejtoreshë është, unë këtë e vërejtja gjatë një leximit të thjeshtë, sugjerimi im është se nuk ke nevojë me e vu krejt barrën për një raport kur dikush tjetër e shkruan e ty ta japin me lexuar në seancë po të hy në hak po mendoj.

**Valbona Makolli:** unë mundohem me bashkëpunua normal fizikisht nuk e bëjë e kontrolloj këtë.

**Leutrim Retkoceri:** shikoj dy raportet e vitit paraprak, atë që e ke bërë ti dhe këtë shiko dallimin ka dallim dhe mosshtruarja.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

#### **Pika e pestë**

**Raport financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1)**

Lidhur me këtë raport në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli** duke cek se edhe në këtë raport sikurse në raportet tjera sipas ligjit të menaxhimit të financave dhe përgjegjësi, kemi paraqitur performancën e tremujorit të parë të vitit 2024, performancën e shpenzimeve, po ashtu kemi paraqitur realizimin e investimeve kapitale, si dhe pasuritë kapitale dhe jokatitale vendimet gjyqësore, si dhe zyrën e përfaqësuesit juridik, për çështjen e detyrimeve kontingjente. Unë për shkak të kohës po e respektoj po shkoj vetëm në pikë të tjera.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Raporti financiar buxhetor i Kryeqytetit për periudhën 1 janar - 31 mars 2024 (TM 1)** dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023**

Lidhur me këtë propozim në pika të shkurta dha sqarime **Lulzim Fushtica** duke cek se ky është raport që është kthyer herën e fundit dhe është diskutuar që jemi pajtuar që ky raport tërhiqet në bazë të kërkesave, komenteve dhe kritikave konsultive që kanë qenë jo vetëm nga anëtarët asamblistë, por edhe nga ne si ekzekutiv. Ne jemi munduar gjatë kësaj kohe që të përmirësojmë gjitha ato, t'i adresojmë gjitha kërkesat që anëtarët asamblistë kanë pasur i kemi adresuar të gjitha kërkesat, kemi pasur konsultë të vazhdueshme me komisionin qendror, i kemi adresuar të gjitha ato kërkesa dhe nesër do paraqesim raportin dhe do të jem i

gatshëm t'i adresojë gjitha ato që anëtarët asamblastë i kanë pasur. Po ashtu tha se e kemi një kërkesë nga asamblasti Muhamet Selmani i cili i ka kërkuar qasje në të gjitha raportet individuale, të cilat janë refuzuar e keni parë ndoshta kërkesën edhe ato që janë pranuar. Dua të potencoj se në bazë të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, e mbrojtjes së privatësisë, ato raporte kanë të dhëna personale domethënë e kanë numrin personal, e kanë llogarinë bankare, numrin e telefonit dhe si të tilla ne nuk mundemi t'i çesim në publik për shkak të Ligjit për mbrojtjen e Privatësisë.

**Nora Kelmendi:** ceku se herën e kaluar drejtor i kam pasur disa pyetje, disa më janë përgjigjur disa jo, për shembull a e keni marrë çmimorën prej ASK-së nuk m'u keni përgjigjur.

**Lulzim Fushtica:** dha sqarime për çështjet e cekura nga parafolësja.

**Nora Kelmendi:** tha se raporti për vlerësimin e dëmeve duhet në kuvend me u dorëzuar prej kryetarit, me mendimin e kryetarit, kryetari nuk ka dhënë mendim, kryetari ka dorëzuar disa dokumente ku askund nuk është mendimi i kryetarit, askund nuk është nënshkrimi i kryetarit. Nesër duheni me sjellë mendimin e kryetarit me nënshkrim që e ka aprovuar raportin, që e ka dërguar komisioni, po mendoj ashtu thotë ligji.

**Shkëmb Manaj:** tha se komisioni është komision i krijuar nga kryetari nuk është i asnjë drejtorie. Unë do ta marrë këtë përgjegjësi që ta prezantojë, për arsye se anëtarët e komisionit nuk kanë qenë të gatshëm por unë do ta prezantojë në emër të anëtarëve të kryesisë dhe do të mundohem që t'i përgjigjemi pyetjeve dhe komenteve që ju i bëni.

**Gëzim Sveçla:** tha se është mirë edhe ato korrespondencat me na i dërguar, pse nuk i kemi në material

**Shkëmb Manaj:** tha do t'i dërgojë patjetër.

**Milazim Vitija:** tha nuk mund të kërkohet prej kryetarit që të bëjë shqyrtim dhe vlerësim të punës të cilën e ka bërë një komision profesional dhe e cila pastaj ka me u vlerësuar prapë në nivel qendror.

**Nora Kelmendi:** tha mirë atëherë e ndërron udhëzimin administrativ.

**Gëzim Sveçla:** A din qysh është dispozitë ligjore ky mendimi i tij, tani mbase kryetari ia ka besuar këtë punë disa personave, logjika shpie që iu beson punës së tyre, ekspertizës së tyre atëherë edhe mendimi që kërkohet në këtë rast që quhet mendimi i kryetarit sigurisht është në përputhje me këtë.

**Nora Kelmendi:** dha sqarime lidhur për çështjen e parashtruar nga parafolësi.

**Milazim Vitija:** tha ne e kemi pasur një seancë pak më herët për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, kanë qenë disa informata shitesë dhe besoj që shumica prej tyre edhe veç u ardhur Rregullorja për menaxhimin e këtyre fatkeqësive natyrore kanë qenë komfor komisionit qendror, prandaj unë iu kisha lutur të gjithëve që ta kalojmë dhe ta miratojmë sepse bujqit që në këto kohë dhe fermerë janë duke pritur për kompensime të dëmeve që janë bërë në vitin e kaluar.

**Leutrim Retkoceri:** tha se ka disa komente, e para në argumente drejtor që i patët se nuk mundeni me dërguar raportet e vlerësimit mbas çka janë vlerësuar personat fizikë apo juridik për dëmet që u ka shkaktuar për shkak mbrojtjes së dhënave personale nuk qëndron. Ju mundeni me i hijëzuar të dhënat e bankave, numrin personal, edhe me emër dhe mbiemër me i dorëzuar. E dyta krejt çështja në seancë që i kemi pasur edhe vërejtjet edhe kritikën, që kanë rezultuar në fund që kanë qenë të sakta është qysh ne me vërtetuar pa pasur qasje në vlerësimin e dëmeve, kur nuk i kemi këto vlerësime ne nuk mundemi me verifikuar, e kur nuk mundemi me verifikuar, unë po flas vetë edhe si grup ne nuk mundemi me votuar një raport që mundet me pasur shkelje. Çështje tjetër që desha me ngritë, në seancën e fundit e kemi parë që raportin e ka arsyetuar drejtoresha e bujqësisë, për shkak se kryesisht dëmet janë në bujqësi, nuk e di pse nuk është tani.

**Lulzim Fushtica:** dha sqarime.

**Shkëmb Manaj:** Është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe drejtorisë së sektorit të emergjencave.

**Leutrim Retkoceri:** tha drejtor është kërkesa e fundit ju duhet t'i dërgoni raportet e vlerësimit, kështu që është mirë me pas qasje në këto vlerësime dhe shpresoj që ato vlerësime janë të njëjta qysh janë bërë që ju kanë thënë, ashtu edhe me pas qasje edhe ne si asamblastë.

**Lulzim Fushtica:** tha plotësisht e kuptoj shqetësimin tënd Leutrim, unë prapë po them qasje çdo asamblistë ka 24/7 në çdo raport që është, çështja ka qenë vetëm publikimi i këtyre raporteve dhe të dhënave personale, përndryshe në çdo raport i kemi të gjitha të skanuara ia dërgojmë, vetëm është çështje se duhet ta keni parasysh se po publikohen nëpër web faqe po publikohen në facebook dhe ne e bëjmë shkeljen e ligjit nëse publikohen të dhënat personale, në rregull për ne, ne jemi të gatshëm.

**Gëzim Sveçla:** tha është obligim i institucionit kur kërkohet qasje dokumenti me i ofruar qasjen, me një- dy-tre reshta fjalë që kush i publikon e merr përgjegjësinë ju largoheni prej përgjegjësisë.

**Lulzim Fushtica:** Në rregull, pa asnjë problem ne i kemi të gatshme.

**Gëzim Sveçla:** pyeti sa është numri i aplikacioneve, po ashtu edhe të refuzuara që janë.

**Lulzim Fushtica:** tha numri i aplikacioneve është mbi 150, ky ka kërkuar edhe të refuzuara, i kemi dërguar por ka kërkuar edhe çdo raport individual.

**Leutrim Retkoceri:** Nuk ka kërkuar asamblistë qasjen në të dhënat personale, ka kërkuar raportin e vlerësimit të komisionit që e ka vlerësuar atë bujk apo atë qytetarë pse është vërshuar, nuk ka kërkuar qasje në të dhëna personale, ka kërkuar qasje në raportin e vlerësimit

**Lulzim Fushtica:** tha po iu përsërisë kërkesën Raporti i vlerësimit komunal për dëmet ku janë specifikuar detajet e kërkesës dhe arsyet, për secilën kërkesë të aprovuar të cekur në dokument domethënë për secilën kërkesë 150 raporte, nuk është problem i kemi të gatshme vetëm unë do ta heq përgjegjësinë, që nëse ato raporte publikohen dijeni që do ta mbart përgjegjësinë dikush tjetër..

**Leutrim Retkoceri:** tha drejtor, këtu ke të bëjë me para publike, kush merr para publike edhe ligji e thotë ka me i dalë emri. Ju nëse mendoni me ia dhënë paratë edhe me i fshehtë emrat.

**Lulzim Fushtica:** tha ne nuk i japim paratë, i jep qeveria. Raporti është publikuar para se me u votuar në kuvend. E keni të qartë, para se me ardhur në kuvend raporti është publikuar.

**Gëzim Sveçla:** tha asamblistët e votojnë raportin komplet, nuk e votojnë rastet individualisht, ajo është ditur që ajo listë ka me qenë, a po kupton, se nuk kemi pasur ne kompetenca për të ndërhyrë jo këtij po ia pranojmë e këtij jo.

**Shkëmb Manaj:** vendimi i kuvendit nuk është vendim përfundimtar në këtë çështje sepse vendimi i kuvendit me gjithë dokumentacionin përgjegjës edhe me gjithë kërkesat e aprovuara edhe me kërkesat e refuzuara dhe me ankesat e palëve kanë me shkuar në komision qendror. Komisioni qendror ka me bërë vlerësim të të gjithë dokumentacionit përfshirë edhe ato ankesat që janë refuzuar prej komisionit komunal dhe ka me i trajtuar edhe gjithë ankesat dhe pastaj merr vendimin përfundimtar.

**Lulzim Fushtica:** Në rregull është kërkesë e juaja, unë do t'ia përcjelli do ta bëj edhe një vërejtje aty që nëse publikohen përgjegjësinë nuk e mban Drejtoria për siguri publike, por e mban përgjegjësi që e publikon.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera pas vërshimeve të mëdha që kanë ndodhur në Komunën e Prishtinës në vitin 2023** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e shtatë**

**Propozim-vendimi për vënien në konsultim publik për Projektregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës**

**Osman Billaca:** tha këtë rregullore e kemi punuar ne, prej auditimit të brendshëm edhe prej auditorit të jashtëm kanë dal këto të gjetura. Këtë rregullore e kemi punuar bashkërisht me Valbonën, Shkëmbin edhe Arbenin edhe një ekip kemi qenë, e kemi bërë një ndryshim të madh me qëllim që mos më u përsërit këto të gjetura.

**Kryesuesi:** ju drejtua z.Manaj mbasi ti po e përfaqëson ekzekutivin po e shfrytëzoj rastin, meqë unë po i drejtohem pra Arben Kqirës se kam pasur edhe këtu para shefave të grupeve me ju drejtuar për një kërkesë që e kam bërë që një muaj, kam nevojë për një vulë të Kuvendit që besoj ligjërisht më takon, dhe që një muaj i shkruaj nuk më kthen email.

**Shkëmb Manaj:** pyeti se kërkesën a e keni adresuar te zyra ligjore.

**Kryesuesi:** Po, atje duhet, a po e merrni përsipër këtë çështje.

**Shkëmb Manaj:** po, kjo shkon përmes komisionit, komisioni e përcjellë në Ministri të Punëve të Brendshme është një procedurë.

**Kryesuesi:** tha jam në dijeni për procedura, por kam lypur opinion prej zyrës ligjore dhe nuk më ka kthyer që një muaj.

**Shkëmb Manaj:** dha sqarime lidhur me këtë propozim –vendim duke cek se kryetari e ka themeluar një grup në të cilin kanë qenë pjesëmarrës nga të gjitha drejtoritë që ndajnë subvencione përfshirë edhe kabinetin edhe zyrën ligjore. Në këtë projektregullore është punuar gati një vit dhe ndryshimet kryesore kanë qenë kështu. E para janë përcaktuar saktë rastet e subvencionimit që bëhen në Rregulloren për subvencionet në Ministrinë e Financave për OJQ dhe subvencionimi që bëhet për personat fizikë sepse kjo nuk ka qenë e përcaktuar saktë në rregulloren që ka qenë në fuqi ka pas mospërputhje mes rregullores qeveritare dhe rregullores së komunës. Subvencionet janë të ndara prej kryetarit pothuajse të gjitha përveç atyre që kanë qenë nën shumën 500 euro kanë shkuar në procedurë prapë në kuvend tani secili subvencion që ndahet prej kryetarit themelohet një komision përkatës profesional, i cili ka me bërë vlerësimin e tyre njëjtë sikurse bëhen subvencionet me thirrje publike. Është rritë vlera e subvencionimit për shpenzimin e varrimit prej 210 euro në 300 euro. Është ngrit vlera e qirasë mujore në rregulloren aktuale do të thotë që është në fuqi ka qenë 150 euro tani është vlera e subvencionimit është deri në shumën 300 euro. Janë përcaktuar subvencionime përmes kuvendit, përpara do të thotë janë subvencionuar ndërmarrjet publike të kryeqytetit ose ku kryeqyteti ka qenë aksionar që nuk kanë qenë fare të përcaktuara me rregullativa tani është përcaktuar që kuvendi ka të drejtë ndaj subvencioneve për nevojat e veta publike ose për ndërmarrjet ku është aksionar. Është përcaktuar subvencionimi për kopshtet e fëmijëve me bazë në komunitet ato do të thotë janë subvencionuar përpara por nuk kanë qenë të përcaktuara në rregullore, si dhe është dhënë mundësia kuvendi me i subvencionuar edhe institucionet tjera që i përgjigjen Komunës së Prishtinës qofshin edhe ato kulturore të trashëgimisë kulturore arsimore dhe të tjera dhe është përcaktuar një shumë që secili subvencion që është mbi shumën 20 mijë euro duhet me doemos me kaluar përmes kuvendit. Janë ndarë fushat e subvencionimit të mirëqenies sociale dhe shëndetësisë, tani është ndarë në dy fusha dhe secila drejtori e di saktë cila është kompetente. Po ashtu i kanë shtuar edhe disa fusha të subvencionimit që e kanë përfshirë edhe përmasat e reja të Ministrisë së Drejtësisë kundër dhunës në familje edhe dhunës ndaj grave janë përfshirë në kuadër të rregullores. Po ashtu e kemi shtuar edhe digjitalizimin e kemi shtuar edhe sigurinë i kemi shtuar edhe disa fusha tjera. Janë thjeshtëzuar shumë procedurat edhe në rregullore si dhe procedurat e aplikimit, më herët kanë qenë të përcaktuara saktë cilat janë kriteret për secilën fushë të subvencionimit por që nuk kanë qenë në përputhje me fusha të caktuara. Po ashtu edhe për çështjen e ankesave, për këtë është komisioni i ankesave për të gjitha rastet se më herët kanë qenë vetëm te thirrjet publike tani e drejta e ankesës iu ka dhënë edhe subvencionet që ndahen prej kryetarit, themelohet komisioni që kanë mandat 2-vjeçar dhe kanë me shqyrtuar të drejtën e ankesave. Mënyra e vendimmarrjes së komisionit të ankesave është përcaktuar me këtë rregullore.

**Nora Kelmendi:** tha veç na shpjegove pse janë heq kriteret te dokumentacioni, a nuk është me mirë këto kriteret e dokumentacionit për secilin subvencion me i pas tani e jo me vonë, kishte qenë mirë kjo rregullore më i pas kriteret tash për secilin subvencionim kjo është nën një , nën dy e keni nën 25 dhe 26 e keni lënë zbrastët, ndoshta rregullohet më vonë po nën 25-26 hiç nuk ka emër, nën 25 dhe vazhdon subvencioni për lehona për tjera dhe nën 26 vazhdojnë disa subvencione tjera.

**Shkëmb Manaj:** tha neni 25-26 ndërlidhet më nenet paraprake të mirëqenies sociale, por që janë nene të veçanta.

**Osman Billaca:** tha ke të drejtë çdo nen është i emërtuar ky nuk është.

**Nora Kelmendi :** tha nuk lidhet hiç 25-26, nuk ndërlidhet më nenet tjera si më pas harru diçka.

**Gëzim Sveçla:** pyeti si kanë menduar pjesën e dëgjimit publik me bërë dhe a ka numër të caktuar sa dëgjime publike duhet me i mbajtur.

**Osman Billaca:** dha sqarime për çështjet e parashtruara nga parafolësi.

**Leutrim Retkoceri:** pyeti se çfarë gjetjesh auditorët i kanë sjell ZKA-së që i keni inkorporuar në këtë rregullore.

**Nora Kelmendi:** tha të gjeturat që kanë qenë a po thua vitin 2022.

**Osman Billaca :**tha këto janë këto të kuvendit që nuk janë bërë.

**Leutrim Retkoceri :** pyeti se çfarë thotë aty.

**Osman Billaca:** shpjegoi se tani thotë që nuk kemi pas lidhje marrëveshje më ta, qysh e bëjmë më të rregullt nuk kanë raportuar në formën e duhur, duhet me caktuar afatin kohor të raportimit, duhet me ju caktuar kriteret pse me kanë dhënë subvencion këto kanë qenë të gjeturat.

**Leutrim Retkoceri:** vërejtja ka qenë pse nuk është shkuar përmes thirrjes publike.

**Nora Kelmendi:** tha kjo është e gjetura e auditorit që të gjitha subvencionet duhet m'u nda përmes thirrjes publike, kështu që Kryetari nuk mundet me nda që e keni hedh një nen të ri përmes Kuvendit që Kryetari me nda subvencione. Ky është një nen i ri që e keni vendos se rregullorja e 2018 nuk pat ndryshime që keni punuar 1 vjet, ndryshimet janë te dokumentet dhe kriteret i keni larguar i keni vendos monitorimin që duhet m'u bërë monitorim dhe që keni me nënshkruar kontratë dhe tjetër ndryshim disa fusha janë shtuar po.

**Shkëmb Manaj:** tha janë shtuar disa fusha ajo është dallimi ne mes subvencionimeve përmes lidhjeve publike se këtu ka edhe subvencionime që janë të drejtpërdrejta, rastet e sëmundjeve.

**Gëzim Sveçla:** tha, po ekzekutivi i ndan në bazë të ligjit, është ligji qysh ndahet subvencioni, është e vërtetë që kuvendi e voton buxhetin për subvencione.

**Shkëmb Manaj:** tha se duke pas parasysh, rregullorja e Ministrisë së Financave e përcakton procedurën e ndarjes së subvencioneve vetëm për OJQ, jo edhe për personat fizikë dhe të tjerët këtu është dallimi d.m.th. ajo e përcakton procedurën për ndarjen e subvencioneve përmes OJQ-ve të cilat duhen në çdo raste me qenë përmes thirrjeve publike.

**Gëzim Sveçla:** tha mendoj që këtu duhet me rregulluar këtë çështje e parimisht unë mendoj që personat fizikë nuk duhet me nda subvencione, por vetëm një kategori në rastet e jashtëzakonshme.

**Shkëmb Manaj:** tha për këtë edhe çështja e kriterëve nuk është përcaktuar sepse ka pasur telashe disa kriteret që kanë qenë të përcaktuar me rregulloren pastaj kanë qenë në kundërshtim me ligjin. Një ndër kriteret që kanë qenë që t'i duhesh me pasur të paguar tatimin në pronë të cilin tash ligji i ka heq krejt d.m.th. nuk është obligative që me marr një subvencion.

**Gëzim Sveçla:** tha pse nuk qitën kriteret tani që me qenë pjesë e rregullores kriteret.

**Shkëmb Manaj :** dha sqarime.

**Gëzim Sveçla:** tha ki vetëm 5-6 kriter kryesore dhe pjesë e rregullores së fundit janë edhe kriteret e tjera të cilat i përcakton drejtoria ose kushto që i ofron dhe këto obligative duhet me qenë bazë një pjesë të mirë pastaj kriteret shtesë lehtë është me qit, por është problemi mos me qit kriteret të lehta që me shkuar paret vend e pa vend.

**Shkëmb Manaj:** tha mundemi të cilat janë obligative, këto kriteret bazë cilat duhet me qenë të përgjithshme për të gjitha rastet.

**Nora Kelmendi:** tha kriteret bazë dhe të përgjithshme të jenë.

**Gëzim Sveçla:** andaj kriteret tjera përcaktohen varësisht çfarë fushe ka të bëj.

**Milazim Vitija:** tha kjo rregullore normal që ka me shkuar në diskutim publik, unë e kam pa këtë rregullore dhe besoj që gjatë diskutimit publik do të dalin edhe kërkesat tjera dhe prapë ka me ardhur ne Kuvend ku na kemi me e rishikuar edhe njëherë edhe me votuar.

**Leutrim Retkoceri:** tha kishe qenë mirë dhe Kryetari herëve tjera nëse është sponsorizues i rregullores. Kjo rregullore ka disa mangësi që kjo ma mirë m'u përmirësuar para se me dalë në dëgjim publik sesa me dalë si e tillë p.sh Komisioni për ndarjen subvencioneve pse me i pasur vetëm 3 anëtarë të brendshëm e mos me qenë edhe 2 përfaqësues të OJQ-ve ose ekspert të jashtëm.

**Osman Billaca:** tha komisioni i ka 1 anëtar të mbrëmshëm dhe 2 të jashtëm.

**Leutrim Retkoceri :** tha se unë po them pse mos me qenë 3 anëtarë të brendshëm edhe 2 të jashtëm.

**Nora Kelmendi :** qysh ka qenë përpara, përpara kanë qenë 5 anëtarë.

**Osman Billaca:** tha këta 3 janë vetëm për subvencione të Kryetarit.

**Leutrim Retkoceri :** tha kjo është gabime është mirë që kjo rregullore me i pasur ka 5 në secilën me qenë 3 të mbrëmshëm dhe 2 të jashtëm, 1 ekspert dhe 1 me qenë përfaqësues prej OJQ-ve, kishte qenë shumë më mirë, kish pas transparenca ma shumë. Po ashtu tha komisionet nuk është mirë me qenë vetëm një komision, është mirë që secila drejtori me pasur komisionin e vet se e njih natyrën dhe fushën se kënd po do me subvencionuar.

**Osman Billaca:** tha secila drejtori e ka komisionin e vet.

**Gëzim Sveçla:** pyeti a ka komisione at hoc. Komision at hoc me rregullore a mundet, praktika e ka dëshmuar që gjithmonë janë më te mirë Komisioni at hoc sepse ekzistojnë mundësitë më të vogla për keqpërdorime se ti se di kush është, kështu e di qe 2 vjet një anëtar është në komision dhe gjithmonë ai më të kryer punë për 2 vjet.

**Osman Billaca:** Komisioni i ankesave është i rregulluar me rregullore të qeverisë që duhet me qenë 2 vjet.

**Leutrim Retkoceri:** tha se i keni bërë edhe përfituesit me prioritet po nuk e keni përfshirë sipas ligjin as veteranët, as familjet e dëshmorëve.

**Shkëmb Manaj:** tha ne mund të bëjmë komisionin e ankesave dhe me bërë në secilën drejtori, për shëndetësi të veçantë, për kulturë, për arsim të veçantë, për mirëqenie sociale dhe jemi në pajtim me rregulloren të cilën nuk e përcakton a duhet 1 - 2 - 3 anëtarë, vetëm që duhet me qenë me afat 2 vjeçar.

Po ashtu tha duhet u përcaktuar 2 përfaqësues, 1 prej OJQ-ve, 1 tjetër prej shoqërisë civile, 2 prej drejtorisë përkatëse.

**Leutrim Retkoceri:** tha shiko edhe ¼ shkon pasi po bazohesh në ligje, ligji i përcakton edhe prioritetet për veteranët dhe familjet e dëshmorëve këtë rregullore ju nuk e keni përfshirë hiç, kështu që është mirë m'u përfshirë, po e shkëlmi ligjin e keni çit përfitues me prioritet.

**Shkëmb Manaj:** tha ato i kemi fut te Kuvendi, në pjesë të subvencionimit i kemi lënë se këtu ndërlidhet vetëm me shoqatën.

**Shkëmb Manaj:** tha ato i ki te kriteret p.sh. i ke te bursat familjet e dëshmorëve këto, për secilin subvencionim ne e kemi kriter që familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës kanë përparësi.

**Leutrim Retkoceri :** tha unë e di ligji i thotë por është mirë m'u certifikuar edhe kriteret edhe këto që i thotë ligji në rregullore, çështja tjetër që është e re që përfshihet këtu e ki edhe subvencionet për zhvillim ekonomik, unë e di që është një drejtori tani që u përmend Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, por MAPL-ja e ka kontestuar atë pa e ndryshuar statusin në Kuvend, tash a po dëshirojmë ne m'i bërë buxhet kësaj drejtorie përmes subvencioneve apo si.

**Shkëmb Manaj :** dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri :** tha kush e bënë subvencionimin e zhvillimit ekonomik.

**Shkëmb Manaj :** tha nuk është ajo që përcaktohet, ato çfarë janë te përcaktuar me ligje janë të përcaktuar

me ligje e ato që nuk janë të përcaktuara me ligj nuk janë.

**Leutrim Retkoceri** : tha këtë po e them këtë që nuk është e përcaktuar me ligje është një interpretim i MAPL –së që kjo drejtori nuk është ligjërish në rregull e formuar, atëherë qysh po ja bënë rregullores, për mendimin tim kështu nuk ja vlejné me e çuar pa e rregulluar edhe më mirë këtë rregullore.

**Shkëmb Manaj**: dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri**: tha edhe të drejtorive vijné po të paktën ato i kanë do rregullore që nisen që më mirë u kanë me i forcuar këto rregullore në bazë të dikastereve që janë se sa me prur te centralizuar diçka , në disa komisione që i ki aty p.sh. Kryetari i Komunës formon komision për këtë kriteret i vendos Kryetari i Komunës, qysh me vendos Kryetari i Komunës kriteret, qysh ja lenë ashtu d.m.th. ZKA-së , po ia lë atë mundësi që me bë kriteret qysh t'i vyen edhe tjetrën e ki nëse doni me marrë, te neni 6 e ki kush mundet me marr subvencion në Komunë të Prishtinës kush jo, pse arti, kultura dhe sporti e keni qit që nuk është obligues me qenë banorë të Prishtinës pse?.

**Shkëmb Manaj** : tha ne si artistë d.m.th. në këtë rastë që Kultura i subvencionon për një projekt të caktuar një artist të veçantë dhe kjo është ideja së në rastë të veçanta nëse ngjarja ndërlihet me territorin e Komunës së Prishtinës ti mundesh edhe një artist prej Shqipërisë kemi rast konkret.

**Kryesuesi** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për vënien në konsultim publik për Projekt-rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

### Të ndryshme

**Valbona Makolli**: tha po i përgjigjem Leutrimit për pyetjen që e ke parashuta sa është diferenca e 2,5 milionëshit të lista e pagave, ajo është për 3 muaj që i bie 883 mijë e diçka është se koeficienti para ligjit ka qenë përafërsisht 60 euro, shkurtë më Ligjin e Pagave është 105 dhe prej janarit është 110, kjo është ajo diferenca është dallimi se e kamë marrë prej zyrës të personelit.

**Gëzim Sveçla** : pyeti kur ka qenë 60, a po para ligjit të pagave.

**Valbona Makolli**: po para ligjit të pagave ka qenë, në vitin e parë muajin shkurt 2023 ka qenë 105 dhe prej janarit është 110.

**Kryesuesi**: tha kam një kërkesë pasi jeni krejt shefat e grupeve, unë kam menduar për mbledhjen e radhës tash pas mbledhjes së nesërme kam menduar deri më datë 10 dhe qysh nesër ose sot menjëherë pas kësaj mbledhje më ju bërë thirrje të gjitha drejtorive më sjell pika që deri me datën 10 më i sjell kush çka për me mundur me mbërri me mbajt edhe një mbledhje tjetër jo me 31 po deri më 24 maj edhe në qershor me i mbajt 2.

**Gëzim Sveçla**: tha një mbledhje duhet me u mësuar se duhet të mbahet gjithë qyshe para dt.15 se këta që marrin pagë tjetër kund nuk po ju dele kjo mëditja.

**Kryesuesi** : Pikërisht është kjo dhe unë ju kamë caktuar këto 3 data , e juaja është vetëm mi zgjedhë dt. 22,23,24.

**Jeta Rafuna**: tha data 23 qenka ma mirë se është e enjte.

**Kryesuesi** : tha varet tani prej Kryetarit tani qysh e ka agjendën, 23 nëse e mbajmë me 23 mbledhjen me datën 22 me mbajt KPF- në, nëse e mbajmë me 24 një ditë përpara KPF-së, vetëm gjithqysh brenda afatit.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:50.*

**Procesmbajtësja**  
**Shyhyrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Fehmi Kupina**



Faqe 10 nga 10